

VENDIM
Nr. 336, datë 4.5.2016

**PËR TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TË TREGJEVE TË
TREGTIMIT ME SHUMICË DHE PAKICË TË FRUTA-PERIMEVE TE NJËSITË E
VETËQEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 1.2, shkronja “a”, dhe 28, pika 2, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe të neneve 3 e 4, të ligjit 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e plotë të aksioneve të shoqërive shtetërore të tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë të fruta-perimeve në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore, sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të hartojë dokumentacionin e duhur të ndryshimit të akteve të themelimit të shoqërive që do të transferohen tek organet e vetëqeverisjes vendore dhe ta depozitojë për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

3. Shoqëritë e tregjeve, që do të transferohen, të mbartin gjendjen e pasurisë së kapitalizuar, përfshirë elementet e aktivitetit dhe pasivitetit që figurojnë në bilancet e tyre. Ajo mbart të gjitha detyrimet kreditore dhe debitore të pasqyruara në bilanc.

4. Organet e vetëqeverisjes vendore, me zotërimin e pronësisë së aksioneve të shoqërive të tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë të fruta-perimeve, të zbatojnë dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punëve të Brendshme, Qendra Kombëtare e Biznesit, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilave u transferohen aksionet e shoqërive të tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë të fruta-perimeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja 1

LISTA E SHOQËRIVE TË TREGJEVE AGROUSHQIMORE, AKSIONET E TË CILAVE DO TË TRANSFEROHEN NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES NË NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

Nr.	Emërtimi i shoqërisë	Statusi	Emri i njësisë së qeverisjes vendore	% e aksioneve
1	Tregu i shitjes me shumicë, fruta-perime Vlorë	SHA	Bashkia Vlorë	100 %
2	Tregu i shitjes me shumicë, fruta-perime Shkodër	SHA	Bashkia Shkodër	67.21%
3	Tregu i shitjes me shumicë, fruta-perime Berat	SHA	Bashkia Berat	100%
4	Tregu i shitjes me shumicë dhe pakicë, fruta perime-Kukës	SHA	Bashkia Kukës	100%